



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.5.2023

Nr: 515

Ora: 18:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 433, NGA PARTIA DEMOKRATIKE ELBASAN, PËR NDALIMIN E TRANSMETIMIT TË MATERIALIT REKLAMUES NË EKRAININ LED NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË, BASHKIA ELBASAN, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 13 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: Partia Demokratike Elbasan

OBJEKTI: Kërkohet ndalimi i transmetimit të materialit reklamues në ekranin LED në sheshin Gensher dhe rruga "28 Nëntori", pranë qendrës së votimit, Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Bashkia Elbasan.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", e pika 2, si dhe neni 79 pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.08.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë", i ndryshuar, dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me denoncues Partia Demokratike Elbasan. Denoncimi është regjistruar me nr. 433 ID, datë 13.5.2023, në regjistrin e denoncimeve.

Data: 13.5.2023 Nr: 515
Ora: 18:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 433, nga Partia Demokratike Elbasan, për ndalimin e transmetimit të materialit reklamues në ekranin LED nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", Bashkia Elbasan, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 maj 2023"

Nëpërmjet këtij denoncimi pretendohet se: *“Në sheshin Gensher si dhe në rrugën ‘28 Nëntori’, pranë qendrës së votimit “Universiteti Aleksandër Xhuvani” në ekran LED shfaqen video në të cilat propagandohet mënyra se si të votohet kandidati për kryetar Bashkie, z. Gledian Llatja nëpërmjet PEVN-së.’*

Pala kërkuese kërkon ndalimin e transmetimit të menjëhershëm të materialit propagandistik të shfaqur në ekranet LED.

Në përgjigje të denoncimit KQZ filloi hetimi administrativ përkatës. Në kuadër të këtij hetimi administrativ, monitoruesit të caktuar nga KQZ për Bashkinë Elbasan, ju kërkua informacion në lidhje me shfaqjen e këtij materiali propagandistik në ekranet LED.

Nga informacioni i dërguar nga monitoruesi rezulton se nga pamjet video të raportuara, materiali i transmetuar në ekranin LED nuk përmban shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor).

Raporti i monitoruesit shoqërohet me foto dhe video të ekraneve LED të monitoruara.

Në datë 03.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, miratoi vendimin nr. 424, “Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...” (vijon emri i subjektit zgjedhor) me të cilin ngarkohet Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike të cilat nuk përmbajnë shënimin.

Me shkresën nr. 4640 prot., si dhe nr. 4651 prot., datë 4.5.2023 i është përcjellur vendimi nr. 424, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të gjitha bashkive si dhe policisë së shtetit.

Nga analiza ligjore dhe pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi, si dhe raporti i monitorimit vlerësoj se materialet propagandistike janë vendosur në kundërshtim të nenit 79 pika 3, të Kodit Zgjedhor,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, si dhe nenin 79, pika 3, të Kodi Zgjedhor dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë Bashkiake Elbasan dhe Policisë së Shtetit për ndalimin e transmetimit menjëherë të materialeve reklamuese (propagandistike) të shfaqura në ekranet LED në sheshin Gensher dhe rrugën “28 Nëntori”, pranë qendrës së votimit, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Bashkia Elbasan.

2. Ky vendim i njoftohet subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit si dhe Policisë Bashkiake Elbasan nëpërmjet postës elektronike.
3. Ngarkohen për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policia e Shtetit si dhe Policia Bashkiake Elbasan.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI